REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË - MINISTAR SPORTA I OMLADINE - MINISTER OF SPORTS AND YOUTH
Nr. prot. 06 Shenja klas. 06
Nr.Prot/Viti 75-8 / 206
Data 29-06-206
Nënshkrimi
Prishtinë

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Sportit dhe Rinisë – Ministarstvo Sporta i Omladine – Ministry of Sport and Youth

---

29.06.2026, Prishtinë

Thirrje për Aplikim për Anëtarë të Jashtëm të Komisionit Vlerësues të Projekteve për Mbështetjen e Aktiviteteve Sportive 2026

Bazuar në Thirrjen Publike për Mbështetjen e Aktiviteteve Sportive për vitin 2026 të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë (MSR), në përputhje me nenin 8, paragrafin 3.2. të Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojmë organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e fushës së sportit, të aplikojnë për të marr pjesë në Komisionin e Vlerësimit në cilësinë:

- *përfaqësues nga OJQ-të;*
- *përfaqësues në cilësinë e njohësit të fushës së sportit.*

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare të fushës së sportit aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohësit e fushës së sportit.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Përfaqësuesi nga OJQ duhet të dorëzojë një letër nominimi nga Personi i Autorizuar i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

Përfaqësuesit e lartë-përmendur do të jenë anëtarë të Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve nga Thirrja Publike për Mbështetjen e Aktiviteteve Sportive për vitin 2026 të pranuara nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës 25.05.2026.

Aplikimi dorëzohet në formë fizike, në zarf të mbyllur, mbi të cilin duhet të shënohet emri dhe mbiemri i aplikuesit, pozita për të cilën aplikon (aplikim – *përfaqësues nga OJQ-të / njohës i fushës së sportit*), si dhe shënimi **Aktivitetet Sportive 2026**. Dokumentacioni dorëzohet në **zyrën nr. 22** (zyra e arkivës) në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, deri më datën **06.07.2026.**

MSR do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuara dhe do të përzgjedhë një kandidat nga OJQ-të dhe një njohës të fushës, të cilët do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues.

Pagesa për pjesëmarrjen e anëtarit të Komisionit Vlerësues të përzgjedhur sipas kësaj thirrje publike do të jetë 500.00 €.